



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Kamenicë shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

| | |
|--------------------------|---------------------------------------|
| Emri i grupit | Specialist i Biologjisë dhe Botanikës |
| Institucioni | Komuna Kamenicë |
| Nr. i Referencës | RN00012523 |
| Kodi | RPC0006074 |
| Data e njoftimit | 12.09.2023 |
| Afati për aplikim | 03.10.2023 - 10.10.2023 |

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të caktuara dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës së Sektorit dhe harton raporte mbi progresin e arritur si dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohen;
- Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime, përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë;
- Siguron zbatimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e bujqësisë dhe identifikon mundësitë për përmirësimin e mëtejshëm të procedurave dhe teknikave që lidhen me fushën e bujqësinë në komunë;
- Ofron mbështetje profesionale për udhëheqësin dhe të gjitha organet tjera lidhur me zbatimin e legjislacionit të bujqësisë;
- Merr pjesë në grupe punuese, ofron këshilla profesionale si dhe ndihmon stafin tjetër të sektorit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- Koordinon dhe bashkëpunon me institucionet qendrore qeveritare dhe organizata tjera lidhur me projektet dhe aktivitet që lidhen me bujqësinë në komunë;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;



2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

i.Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve:Biologji/Botanikë/Prodhim Bimor/Agronomi

ii.Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase;

iii.Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

i. Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike

ii. Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;

iii. Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;

iv. Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;

v. Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;

vi. Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;

vii. Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Pozitat aktualisht të lira



| Kodi | Nr. i Referencës | Titulli i pozitës | Klasa e pozitës | Koeficienti | Institucioni | Organizata / Vendi i punës | Nr. i kërkuar |
|------------|------------------|-------------------------------|-----------------|-------------|-----------------|---|---------------|
| RPC0004736 | RN00011088 | Zyrtar për Prodhimtari Bimore | Profesional 2 | 6 | Komuna Kamenicë | Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural / Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural | 1 |

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- i. Kopjet e dokumentit personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- ii. Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore (personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit);
- iii. Kopjet e dëshmisë së punësimit;
- iv. Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- v. Certifikat që nuk jeni nën hetime (jo më të vjetër se nga data e shpalljes së konkursit)

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë



9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

- i. Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike.
- ii. Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë.
- iii. Njohuri të mira të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve.
- iv. Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës.
- v. Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave.
- vi. Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale.
- vii. Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

